

KONTRATA SOCIALE VLORE

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE SHTATOR 2020-SHTATOR 2021

Viti i II-të i monitorimit

PËRGATITUR NGA:
QENDRA RINORE E VLORËS

RAPORTI MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

TË KONTRATËS SOCIALE

BASHKIA VLORË

POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

Shtator 2020 – Shtator 2021

Përgatiti raportin: Qendra Rinore e Vlorës

Tabela e Përmbajtjes

FALENDERIME	4
RRJETI POP	5
SHKURTIME	6
HYRJE	7
METODOLOGJIA	9
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	10
KONTRATA SOCIALE BASHKIA VLORË	10
KËSHILLI BASHKIAK DHE VEPRIMTARIA E TIJ	11
VLERËSIMI I QYTETARËVE	12
ANALIZA E GJETJEVE PËR SECILIN PRIORITET SIPAS KONTRATËS SOCIALE	15
PRIORITET NR. 1: INFRASTRUKTURË, RRUGË DHE TROTUARE	16
PRIORITET NR. 2: FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM	19
PRIORITET NR. 3: KANALIZIMET	22
PRIORITET NR. 4: TRANSPORTI PUBLIK	23
PRIORITET NR. 5: TRANSPORTI PUBLIK	24
PRIORITET NR. 6: PASTRIMI	24
PRIORITET NR. 7: PASTRIMI	26
PRIORITET NR. 8: ZHVILLIM EKONOMIK	28
PRIORITET NR. 9: ZHVILLIM EKONOMIK	29
PRIORITET NR. 10: ZHVILLIM EKONOMIK	30
PRIORITET NR. 11: DEMOKRACIA VENDORE	30
PRIORITET NR. 12: DEMOKRACIA VENDORE	31
REFERENCA	32
ANEKS	33

Falenderime

Për të hartuar këtë raport gjatë periudhës Shtator 2020 - Shtator 2021, dëshirojmë të falenderojmë në radhë të parë qytetarët dhe të rinjtë që ishin pjesë proaktive e këtij monitorimi, mediat lokale dhe sociale që veprojnë në qytet, Bashkinë Vlorë me drejtoritë e institucionet e varësisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Një falenderim shkon dhe për anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) të cilët kanë kontribuar për monitorimin dhe përgatitjen e raporteve të ngjashme të monitorimit në bashki të tjera ku rrjet punon.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED – National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohej ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjetit POP.

Rrjeti POP

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë vendore, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të programit të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

Ky raport është përgatitur nga Qendra Rinore e Vlorës në kuadër të projektit POP 2020 “Monitorimi i zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy.

Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e Qendrës Rinore Vlorë.

Shkurtime

POP	Përballja e Ofertave Politike
NJQV	Njësi të Qeverisjes Vendore
Nj.A	Njësi Administrative
RAT	Reforma Administrative-Territoriale
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
U.K Vlorë	Ujësjetllës Kanalizime Vlorë Sh.a.
OPIC	Qendra Ndërkombëtare Olof Palme
NED	National Endowment for Democracy
VYC	Qendra Rinore e Vlorës
QAGJZH	Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”
KB	Këshilli Bashkiak
VKB	Vendime të Këshillit Bashkiak
SH.A.U.K	Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Vlorë
AKUM	Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve

Hyrje

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë vendore, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë), ndërsa tre bashki të reja u bënë pjesë e këtij procesi në vitin 2021, përmes replikimit të procesit edhe në bashkitë e Elbasanit, Vau i Dejës dhe Korçë. Gjatë periudhës shtator 2020-2021, rrjeti POP monitoroi zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Kontrata Sociale në Vlorë përmban 12 prioritete që qytetarët e Vlorës identifikuan në zgjedhjet lokale të 2019. Qendra Rinore e Vlorës si anëtare e rrjeti POP, synoi të krijojë dhe promovojë mekanizma qytetare në funksion të përmirësimit të demokracisë lokale, duke angazhuar qytetarët, partitë politike, kandidatët për deputetë në zgjedhjet parlamentare të 2021, stafin e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak të nisin dialogun dhe të punojnë për realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale.

Qendra Rinore e Vlorës mundësoi vlerësimin dhe monitorimin e performancës së administratës lokale dhe të zgjedhurve vendorë duke promovuar dialog dhe bashkëpunim në nivel vendor. Në Bashkinë Vlorë, Kontrata Sociale bëri që komuniteti të ketë një mjet për të mbajtur stafin e bashkisë dhe Këshillin e Bashkiak përgjegjës për adresimin e tyre, por duke përdorur edhe zgjedhjet parlamentare të 2021, advokoi me të gjitha partitë politike dhe kandidatët e tyre për të futur në agjendat politike edhe prioritetet e Kontratës Sociale.

Ky raport i dytë monitorimi analizon dhe vlerëson progresin e 12 prioriteteve të Kontratës Sociale për periudhën shtator 2020 – shtator 2021, në Bashkinë e Vlorës.

Prioritetet e Kontratës Sociale ofrojnë një mundësi shumë të mirë që bashkia të kuptojë nevojat dhe përparësitë e qytetarëve. Harmonizimi dhe përfshirja e rezultateve të monitorimit në programet vendore përmes advokimit si dhe përpjekja për të influencuar në hartimin e politikave vendore, duke përdorur procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje janë një tregues pozitiv i rritjes së transparencës dhe llogaridhënies.

Gjatë periudhës shtator 2020 – shtator 2021, Qendra Rinore e Vlorës dhe rrjeti POP kishte qëllim:

- Të prezantojë raportin e parë të monitorimit të Kontratës Sociale midis grupeve qytetare, organizatave të shoqërisë civile, gazetarëve lokalë, stafit të bashkisë, këshillit bashkiak, partive politike garuese në zgjedhjet parlamentare të 2021;
- Të monitorojë veprimtarinë e Bashkisë Vlorë dhe Këshillit Bashkiak për adresimin e prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të bashkëpunojë me partitë politike përmes realizimit të forumit me kandidatë për deputetë në zgjedhjet parlamentare të 2021;
- Të realizojë takime dhe fokus-grupe me komunitetin për të matur progresin e prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet në mediat lokale dhe ato sociale për të informuar komunitetin;
- Të llobojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve sidomos në kuadër të Dimensionit Social, Transparencës dhe Llogaridhënies.
- Të përgatisë raportin e dytë të monitorimit dhe gjetjet e rekomandimet të prezantohen në nivel kombëtar dhe atë lokal.

Metodologjia

Për të realizuar raportin Qendra Rinore e Vlorës, pjesë e rrjetit të POP u bazua në hapat si më poshtë:

- U monitorua puna e Bashkisë Vlorë dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për periudhën shtator 2020 – shtator 2021;
- Kërkesa për informim iu dërgua bashkisë dhe institucioneve të varësisë.
- Monitorim i mbledhjeve ofline dhe online të Këshillit Bashkiak;
- U organizuan takime me staf të Bashkisë Vlorë mbi progresin e prioritetëve të komunitetit;
- U kontaktuan gjithë partitë politike garuese në zgjedhjet parlamentare të prill 2021, ku u njohën me procesin dhe u diskutua mbi raportin e parë të monitorimit të prodhuar nga projekti.
- U realizuan takime me anëtarë të komunitetit në Nj.A të Vlorës, që vlerësuan progresin e prioritetëve të Kontratës Sociale;
- Monitorimi i implementimit të buxhetit dhe prioritetëve të Kontratës Sociale përmes të dhënave të hapura dhe prokurimeve publike;
- Konsultimi i dokumentave dhe strategjive të Bashkisë Vlorë, buxheti afatmesëm dhe ai vjetor, faqja e internetit e Bashkisë, etj;
- Analizim i monitorimit të mediave audio vizive dhe online sipas fushave specifike.

Përmbledhje Ekzekutive

Ne jemi të vetëdijshëm që realizimi i prioriteteve të Kontratës Sociale kërkon shumë investime në burime njerëzore por edhe më shumë në burime financiare dhe Bashkia Vlorë me buxhetin vjetor ose afatmesëm që administron, mundësitë e ka të të limituara. Edhe pse Bashkia e Vlorës përballet me shumë sfida për të adresuar zgjidhje te komuniteti i saj, është e rëndësishme të theksojmë se *adresimi i nevojave, diskutimi e monitorimi* i tyre nga qytetarët dhe stafi i NJ.Q.V është në funksion të ngritjes së urave të komunikimit, duke kuptuar njëri-tjetër për të përmirësuar ndërveprimin midis palëve, duke forcuar në këtë mënyrë edhe demokracinë lokale.

Raporti i Monitorimit të Kontratës Sociale, për periudhën 2020 – 2021, bazohet mbi progresin e çdo prioriteti qytetar që bashkia e Vlorës realizon në punën e saj të përditshme dhe vendimarrjes së Këshillit Bashkiak.

Të 12 prioritetet janë adresuar pjesërisht përmes hartimit të projekteve, planifikimit në buxhetin vendor, projekteve qeveritare dhe ndërmarrjes së nismave e politikave për përmirësimin e tyre, në total të 12 prioriteteve vlerësojmë se nga **47.17%** e tyre që janë realizuar në raportin e parë periudha 2019-2020, në këtë raport të dytë monitorimi për 2020-2021, janë realizuar rreth **65,25%**.

Çdo prioritet i Kontratës Sociale përmban një listë të gjatë indikatorësh, ndërsa theksojmë se ka përpjekje pozitive nga Bashkia Vlorë, ku pjesa më e madhe e prioriteteve janë janë adresuar me investime të drejtëpërdrejta, ndërsa janë hartuar projektet për studimin e fizibilitetit për prioritetet që kanë nevojë për tu mbështetur financiarisht edhe nga qeverisja qendrore apo donatorë, apo edhe prioritetet që nuk kanë nevojë për ndërhyrje financiare, por janë vendosur në agendën e punës nga Bashkia Vlorë. Gjatë kësaj periudhe monitorimi është vënë re një vëmendje e shtuar me ndërhyrjeve me investime drejt Njësisve Administrative.

Kontrata Sociale Bashkia Vlorë

Autoritetet lokale janë përgjegjëse për të garantuar që qytetarët marrin shërbime dhe mbështeten për mirëqenien e tyre. Por janë qytetarët, të rinjtë dhe aktorët e shoqërisë civile, që përmes mekanizmave të ndryshëm qytetarë duhet t'i mbajnë ata përgjegjës në formulimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe shërbimeve lokale.

Në Kontratën Sociale qytetarët kanë dhënë opinionet e tyre për 26 çështje që përfshihen në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor: (i) Shërbimet publike; (ii) Zhvillimi ekonomik vendor; (iii) Dimensioi social dhe (iv) Demokracia vendore. Nga të gjitha këto prioritetet, u veçuan si më prioritare 12 prej tyre të cilat u përfshinë në Kontratën Sociale – Vlorë.

Identifikimi i prioriteteve konkrete për çdo njësi administrative të Vlorës, ishte një hap i rëndësishëm për procesin. Në bazë të këtyre prioriteteve, më datë 11.10.2019, mes Bashkisë Vlorë dhe Qendrës Rinore të Vlorës u firmos Kontrata Sociale.

Prej momentit të nënshkrimit, Qendra Rinore e Vlorës, pjesë e rrjetit të organizatave që implementojnë në rang kombëtar projektin POP – Përballja e Ofertave Politike, është duke monitoruar përmbushjen e prioriteteve dhe pritshmëritë që komuniteti ka ndaj kësaj Kontrate Sociale.

Ndërsa Shqipëria ishte në prag të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021 dhe qytetarët e të rinjtë, vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar, në mënyrë që të adresohen nevojat dhe shqetësimet e tyre u realizua një forum online, me pjesëmarrje të kandidatëve për deputetë nga 5 partitë garuese në këto zgjedhje, ku u disuktuan e çështje me interes për komunitetet lokale.

Këshilli bashkiak dhe veprimtaria e tij

Këshilli Bashkiak gjatë periudhës së monitorimit shtator 2020 – shtator 2021, ka realizuar në total 18 mbledhje, nga të cilat 14 mbledhje online ku janë marrë 61 vendime dhe 4 ballë për ballë në ambiente publike, ku janë marrë 38 vendime.

Këshilli Bashkiak i Vlorës për periudhën e monitorimit ka aprovuar ne total 99 vendime ndërsa nënvizohet se duhet të rrisë komunikimin dhe ndërveprimin me qytetarët dhe aktorë të rëndësishëm të territorit, ndërsa do të duhet ende kohë dhe përpjekje që praktikrat që ka prodhuar të njihen dhe të vihen në jetë nga ky institucion vendimarrës. Në periudhën qershor-gusht 2021, KB dhe Bashkia Vlorë u përfshinë në një marrëdhënie bllokuese midis tyre, duke manifestuar komunikim të munguar dhe njohje të pakët legjisacionit e të rregulloreve të aprovuara nga organi vendimarrës dhe vonesa në shërbimet ndaj qytetarëve. Në këtë situatë rekomandojmë që Bashkia Vlorë dhe KB Vlorë duhet të luajë rolin që qytetarët i kanë mandatuar, duke qënë më pranë komunitetit dhe duke mbështetur shqetësimet e tyre në vendimarrje gjithëpërfshirëse dhe jo të njëanshme.

Qendra Rinore e Vlorës gjatë periudhës së monitorimit punoi për të adresuar kërkesat dhe ankesat, por edhe progresin e prioriteteve të Kontratës Sociale drejt Bashkisë Vlorë apo edhe KB, ndërsa media lokale vazhdon të mbështesë shqetësimet e banorëve përmes kronikave ose lajmeve në mediumet lokale, që prioritetet qytetare të adresohen për zgjidhje. Emisione në TV lokale, radio dhe postime në mediat sociale, informuan qytetarët mbi gjetjet e raportit të parë të monitorimit mbi progresin e prioriteteve të Kontratës Sociale.

Publiku, Bashkia Vlorë, partitë politke dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak janë mbajtur të informuar përmes takimeve ballë për ballë, shpërndarjes së raportit dhe informacionit në mediat lokale, sociale por edhe në faqen e internetit të rrjetit POP.

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, në prill të 2021, ishin një tjetër mundësi, që Qendra Rinore e Vlorës përdori për të futur prioritetet e Kontratës Sociale në programet politike ku përmes takimeve me çdo parti politike garuese për zgjedhjet parlamentare, kërkoi të advokonte për zgjidhje dhe mbështetje të 12 prioritetëve të Kontratës Sociale. Në këto takime partitë politike dhe kandidatët për deputetë u njohën nga afër me 12 prioritetet e Kontratës Sociale, raportin e parë të monitorimit dhe gjetëm mbështetje nga kandidatët/partitë politike që disa prej prioritetëve të advokohet për zgjidhje edhe në nivel qendror.

Vlerësimi i qytetarëve

Pjesëmarrja qytetare në monitorimin e Kontratës Sociale vlerësohet pozitive, qytetarët janë pyetur dhe kanë dhënë komente për progresin ose realizimin e çdo prioriteti. Fokus-grupe, tryeza diskutimesh, takime ose edhe votime online (pjesë e procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje për 2021) kanë sjellë shqetësimet kryesore mbi prioritetet që mbeten ende për tu adresuar dhe për tu buxhetuar nga ana Bashkisë Vlorë.

Periudha parazgjedhore shkurt-prill 2021, ishte një moment për të ndërgjegjësuar qytetarët/mediat lokale për të informuar dhe matur progresin e çdo prioriteti të Kontratës Sociale. Një tryezë diskutimi me anëtarë të shoqërisë civile dhe takime në mediat lokale informuan rreth 22 (16F/6M) aktorë të jetës publike në Vlorë. Një bisedë në studio televizive dhe radio lokale u prezantuan gjetjet e monitorimit dhe u ndërgjegjësua komuniteti dhe vendimarrësit mbi realizimin e prioritetëve sociale dhe futjen e tyre në agendat politike të partive politike në periudhën parazgjedhore.

Për monitorimin dhe marrjen e reagimit nga komuniteti mbi progresin e prioritetëve të Kontratës Sociale, gjatë periudhës korrik – tetor 2021 janë realizuar 4 takime me komunitetin me pjesëmarrje të 61 personave nga të cilët 40 vajza/gra dhe 21 djem/burra.

Gjatë takimeve me qytetarët që u zhvilluan në periudhën korrik–tetor 2021, u prezantuan prioritetet e Kontratës Sociale dhe u kërkua vlerësimi komunitar për përmirësimin e situatës së identifikuar. Qytetarët ishin të vetëdijshëm që shumë prej prioritetëve kërkojnë investime madhore të Bashkisë Vlorë, ndërsa periudha e zgjedhjeve parlamentare, duket që ndikuar pozitivisht në investimet në qytet dhe Nj.A.

Gjithsesi pjesëmarrësit diskutuan për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, përmes vlerësimeve që dhanë për çdo prioritet.

Ndërsa një pjesë e mirë e prioritetëve, janë artikuluar edhe në takimet e Buxhetimit me Pjesëmarrje në periudhën tetor–nëntor 2021, si prioritete që kanë nevojë të adresohen me mbështetje financiare në buxhetin vendor, ku Qendra Rinore e Vlorës ka asistuar 6 dëgjesa publike, me një pjesëmarrje prej 151 (55F/95M) personash në total.

Tre plane advokimi për prioritetet e Kontratës Sociale u përgatitën dhe u realizuan përgjatë periudhës korrik–nëntor 2021. Si përfundim dy peticione për dy prioritete që janë: 1. Shtrimi i rrugës së Kishës së Marmiroit – Nj. A Oriku dhe 2. Investime në rrugën lidhëse midis fshatit Kërkovë dhe

Bestrovë, janë dërguar Komisionit të Ankesave, Kërkesave dhe Peticioneve të KB Vlorë. Rreth 36 qytetarë (23M/13F) kanë nënshkruar të dy petitionet. Ndërsa aktivizimi i Këshillit Vendor të Rinisë nga Bashkia Vlorë, bazuar në Ligjin për Rininë, ka marrë jetë në mbledhjen e muajit dhjetor të KB, ku janë miratuar procedurat dhe kriteret për ngritjen dhe funksionimin e këtij Këshilli.

Më poshtë po listojmë gjetjet nga takimet me qytetarët për çdo prioritet të Kontratës Sociale.

Prioriteti 1: - Investimet e realizuara që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe blloqet e banimit, janë duke dhënë rezultate pozitive për komunitetin në qytet. Theksojmë se gjatë zgjedhjeve parlamentare mjaft prej rrugëve të indentifikuara nga qytetarët për ndërhyrje janë përmirësuar me investime konkrete dhe nga 50% e prioriteteve në raportin e parë të monitorimit për periudhën shtator 2020-shtator 2021, janë realizuar rreth 70% e investimeve në qytet, ndërsa është ende duke u punuar për finalizimin e tyre. Në takimet e realizuara, qytetarët shprehen se ka ende shumë punë për tu bërë, për përmirësimin e infrastrukturës rrugore.

Në Njësitë Administrative shumë rrugë mbeten për tu rregulluar, gjithsesi qytetarët kanë identifikuar dhe vlerësuar pozitivisht ato pak ndërhyrje që bashkia realizoi në periudhën mars-maj 2021. Ndërsa janë përshëndetur nga komuniteti i Nj.A Orikum, për investim në rrugën e Tragjasit dhe rruga buzë detit është bërë pjesërisht gjatë zgjedhjeve parlamentare, mbetet ende për tu shtruar edhe ana tjetër e rrugës në drejtimin e postbllokut të vjetër në Orikum. Në Nj.A Qendër, banorët shprehen se është përmirësuar rruga në aksin Panaja – Hoshtimë dhe rruga Babicë e Vogël – Xhyherinë. Gjithsesi ata kërkojnë ende më shumë investime në këtë zonë në infrastrukturën rrugore kryesisht në akset Kërkovë-Bestrovë, Babicë, që prej vitesh nuk kanë patur investime. Në Nj.A Novoselë kërkohet ende sistemimi i rrugëve lidhëse me qytetin, edhe pse rrugët ekzistojnë ato kanë nevojë për mirëmbajtje. Ndërsa njihet nga banorët investimi i realizuar në aksin Cerkovinë-Skroftinë-Trevllazër si një mundësi shumë e mirë për të përmirësuar jetën e komunitetit në fshatrat ku ndërhyrja u realizua.

Prioriteti 2: - Në qytetin e Vlorës qytetarët shprehen se janë të pakënaqur me aksesin që kanë për tu furnizuar me ujë të pijshëm, edhe pse kanë dëgjuar për projekte të mëdha që do të ndryshojnë situatën, por deri në shtator të 2021, ata shprehen se vazhdojnë të vuajnë mungesën e furnizimit me ujë, ndërsa identifikojnë se ka patur avari të shumta në rrjetin e furnizimit me ujë. Zonat e lagjes “Partizani”, “Karabash”, “Fabrika e Çimentos” dhe Babica e Vogël vuajnë prej kohësh mungesën e ujit të pijshëm dhe kanë patur problematika në furnizimin me ujë, ndërsa gjatë periudhës së zgjedhjeve, në muajin prill qytetarët shprehen se janë informuar për ndërhyrjet që do të kryhen në këto zona dhe shpresojnë se pas përfundimit të punimeve në vitin 2022 do të kenë mundësi të zgjidhet problematika disavjeçare e furnizimit me ujë.

Qytetarët e Vlorës identifikojnë edhe projekte madhore, ku investitor është Qeveria Shqiptare kryesisht për zonën e Lungomares dhe atë të Transballkanikes. Situata vlerësohet pa shumë rezultate për banorët ndërsa bashkia ka gjetur financim për për ujësjellësin e 15 fshatrave në Nj.A Novoselë. Përsa i përket Nj.A Novoselë, zona vazhdon të vuajë për ujë, sidomos në periudhën e verës, për shkak të rrjetit të amortizuar dhe shtrirjes së gjatë të linjave të ujit

Në Nj.A Orikum edhe pse ka mbaruar investimi për zonën Dukat – Tragjas- Radhimë fshat dhe është përmirësuar ndjeshëm situata, edhe me përfundimin e rezervuarit të ujit, nuk janë bërë ende lidhjet

me Orikumin, ku situata vazhdon të mbetet njëlloj, Orikumi furnizohet me ujë 2 herë në ditë nga 45 minuta. Ndërsa zona bregdetare e Radhimës nuk furnizohet ende me ujë edhe pas investimeve të kryera, ka filluar shtrirja e tubacioneve në disa zona të veçanta.

Në Nj.A Qendër qytetarët raportojnë se vazhdojnë të vuajnë mungesën e ujit të pijshëm në të gjithë fshatrat e kësaj njësie. Rrjeti shpërndarës është i amortizuar dhe cilësia e ujit është jashtë normave të parashikuara për t'u pirë nga banorët. Sidomos e theksuar kjo në fshatrat Kërkovë, Panaja dhe Bestrovë. Ndërsa në muajin qershor banorët e kësaj zone, kanë realizuar një protestë në bashkinë Vlorë, duke nënshkruar një peticion.

Prioriteti 3: - Përmirësimi i cilësisë së kanalizimeve, vazhdon të mbetet një sfidë për Nj.A ku pothuajse nuk ekziston rrjeti i kanalizimeve, ndërsa në Vlorë në disa zona të veçanta të saj, është përmirësuar ndjeshëm sistemi i kanalizimeve të ujrave të zeza. Gjithashtu në shëtitoren buzëdetit, ujrat e zeza dhe të bardha nuk derdhen më në det, ndërsa sistemimi i kanalizimeve të ujrave të bardha në zonat që përmbyteshin rregullisht është raportuar nga qytetarët si një prioritet që po merr vëmendjen e duhur nga ana e Sh.A.U.K Vlorë.

Prioriteti 4:- Në lidhje me transportin publik, nevojitet përmirësim dhe shtim i linjave të reja jo vetëm në zonat periferike të qytetit, por edhe në Nj.A. Ndërsa periudha e verës vuri në vështirësi serioze shërbimin e transportit, kryesisht gratë dhe operatorët turistikë kërkojnë afishim të orareve dhe linja të shtuara të shërbimit në zonën turistike dhe në fshatra të Vlorës. Transporti midis Nj.A- ve dhe Vlorës është zgjidhur përmes linjave private të furgonave privatë. Ka nevojë për zgjatje të orarit, sidomos gjatë verës për personat në punë sezonale me orare të vona. Ky prioritet ka nevojë të adresohet për zgjidhje nga ana e bashkisë Vlorë.

Prioriteti 6:- Edhe pse në bashkinë e Vlorës ka filluar puna për ndërtimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane, në zonën e Sherishtës, qytetarët e sidomos përfaqësues të shoqërisë civile kishin pak ose aspak informacion mbi këtë vepër madhore që pritet së shpejti të bëhet funksionale për të ofruar shërbimin e grumbullimit dhe përpunimit të mbeturinave për bashkitë e Vlorës dhe Selenicës.

Ndërkohë për prioritetin 7, atë të përmirësimit të pastrimit të qytetit dhe Nj.A, qytetarët raportojnë se është një shërbim që realizohet por ka nevojë për përmirësim. Në Nj.A Qendër dhe Shushicë, ofrohet prej shtatorit 2020 shërbimi i pastrimit të mbeturinave, nga firma e kontraktuar nga bashkia Vlorë. Ndërsa në zonën bregdetare të Vlorës dhe Radhimës kërkohet që firmat e kontraktuara të përmirësojnë shërbimin duke shtuar mjete dhe punonjës gjatë sezonit të verës, ku turistët janë të shumtë në numër.

Prioriteti 8:- Zhvillim i programeve për mbështetjen e fermerëve prej shtatorit të 2020 e deri në shtator të 2021, është raportuar si një shërbim pozitiv nga ana e bashkisë Vlorë. Përmes takimeve të shumta, kryesisht në Nj.A fermerët janë asistuar duke marrë informacione dhe shërbime për të rritur prodhimin në fermat ose bizneset bujqësore të njëjse. Ndërsa procesi i menaxhimit të tokave, vazhdon të realizohet me me ritme të ulta, ndërsa nevojitet më tepër mbështetje për këtë prioritet të rëndësishëm.

Prioriteti 9: Qytetarët shprehen bashkia e Vlorës i informon dhe mbledh taksat rregullisht, ndërsa kërkojnë që një Nj.A që janë të varfra, taksat dhe tarifatat të jenë më të ulta për familjarët. Ndërsa kërkojnë që sektori i biznesit të paguajë më shumë detyrime, kjo bazuar edhe në bizneset që frekuentohen më shumë nga turistët. Gjithsesi qytetarët dhe bizneset kërkojnë që për cdo ndryshim të taksave dhe tarifave të jenë të njoftuar më parë dhe jo të vihen para faktit të kryer në sportelet ku bëhen pagesat.

Prioriteti 10:- Bashkia dhe Këshilli Bashkiak duhet të ndërmarrin nisma që fuqizojnë aksesin në punësim kryesisht në sektorin e turizmit për kategoritë e grave dhe të rinjve. Janë hedhur disa hapa të parë, por kërkohet që të punohet më shumë, dukë parë edhe profilin e Vlorës, si një qendër e rëndësishme e turizmit. Ndërsa të pyetur mbi mundësitë që ofron Bashkia apo KB për këtë prioritet, qytetarët shprehen se kanë informacion të limituar dhe nuk njohin qëndra apo nisma që ofron bashkia për formimin profesional të grave apo të rinjve.

Prioriteti 11:- Buxhetimi me Pjesëmarrje është një praktikë pozitive e realizuar prej disa viteve në bashkinë Vlorë, ndërkohë që qytetarët shprehen se kanë shumë pak informacion dhe kur realizohen takimet ata nuk informohen paraprakisht. Në disa Nj.A si në Orikum dhe Qendër ata shprehen se takimet me komunitetin janë pakta dhe zakonisht kujtohen vetëm në periudha zgjedhesh të dëgjojnë nevojat e qytetarëve. Gjithsesi ata kërkojnë që administratoret ti mbajnë të informuar dhe ti njoftojnë kur bëhen takime të hapura ose dëgjesa me publikun.

Prioriteti 12:- Bashkia e Vlorës ka ngritur Këshillin Vendor të Rinisë, por nevojiten përpjekje që kjo strukturë të jetë aktive dhe të përfaqësojë të rinjtë në vendimarrje. Një pjesë e mirë e të rinjve të pyetur kanë shumë pak informacion mbi format e bashkëpunimit midis tyre dhe bashkisë, ndërsa propozojnë mbështetje nëse KVR-së do të jetë aktiv për të ndërmarrë iniciativë të përbashkëta.

Analiza e gjetjeve për secilin prioritet sipas Kontratës Sociale

Ky raportim është bazuar në përgjigjet e kërkesës për informacion që Qendra Rinore e Vlorës i ka dërguar bashkisë Vlorë, takimeve me staf të bashkisë, në monitorimin në terren të aksioneve dhe punës së bashkisë, monitorimin e mediave (kryesisht medias sociale) si dhe në informacionet e mbledhura nga të dhënat e hapura (shpenzime dhe prokurime) të qeverisjes vendore si dhe nga takimet me qytetarë të njësive administrative të bashkisë Vlorë. Gjithashtu janë analizuar dhe vendimet e miratuara nga Këshilli Bashkiak i Vlorës për periudhën shtator 2020 – shtator 2021.

Progresi i realizimit të prioriteteve raportohet në disa faza që janë:

Prioritet i pa realizuar

Prioritet i adresuar pjesërisht (Prioritet i buxhetuar ose Prioritet i prokuruar)

Prioritet i realizuar

Nga analizimi i këtyre të dhënave rezulton se bashkia Vlorë ka adresuar prioritet si më poshtë:

PRIORITET NR. 1: INFRASTRUKTURË, RRUGË DHE TROTUARE

- Investime që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe blloqet e brendshme të banimit.

Për rajonet e qytetit Vlorë. I nevojshëm rikonstruksioni i rrugëve ose i blloqeve të brendshme të banimit: Zona tek Fusha e Drurit, rruga tek Tregu i Madh, rruga pas KSHA-së, lagjia pas kopshtit Nr 10, rruga nga fabrika e tullave, rruga nga Porti drejt plazhit të vjeter, rruga “Jani Kosta”, rruga dhe e gjithë lagjia pas Stadiumit, rruga tek fusha e aviacionit. Vendosje e sinjalistikës horizontale dhe/ose vertikale në zonat ku aktualisht mungon.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Gjetjet nga raporti i parë i monitorimit për periudhën gusht 2019-2020, ku nga 10 indikatorë ishin përfunduar me investime konkrete 5 të tillë, që vlerësonte progresin në masën 50%, treguan se në periudhat e fushatave zgjedhore autoritetet punojnë intesivisht për realizimin e investimeve konkrete sidomos ato që kanë të bëjnë me investime në infrastrukturë, rrugë dhe trotuare. Gjatë monitorimit të periudhës së dytë shtator 2020-shtator 2021, janë realizuar një sërë investimesh për rikonstruksionin e rrugëve dhe blloqeve të banimit në qytet. Në rrugët e përfshira në Kontratën Sociale për Vlorën janë realizuar ndërhyrjet si më poshtë:

Rruga në lagjen “11 Janari” nga hyrja e Pusit të Mezin deri te ish fabrika e tullave është rehabilituar. Punimet janë kryer nga firma Gener 2 dhe është realizuar gërryerja dhe riasflatimi, ndriçimi i rrugës, ndërtimi i trotuareve që më parë mungonin dhe kanaleve kulluese. Punimet kanë përfunduar në fund të muajit Prill 2021. Ndërhyrja u kryhe në gjatësinë prej 1.5 kilometër dhe rehabilitimi përfshiu të gjithë infrastrukturën: sistemin e kanalizimeve, kullimit dhe atë të ndriçimit. Ndërsa kjo ndërhyrje nuk është financuar nga Bashkia Vlorë, por nga Qeverisja Qendrore. *Prioritet i realizuar plotësisht.*

Rruga dhe e gjithë lagjia pas Stadiumit – ose rruga “Mato Robi” nga kryqëzimi i rrugës “Dush Strati” deri te kryqëzimi me rrugën “Pelivan Leskaj” ka qenë gjithmonë problematike dhe për këtë arsye janë realizuar herë pas here riparime të saj. Në Mars 2021, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ka ndërhyrë duke bërë mbushjen me çakëll të kësaj rruge. Kjo rrugë gjithashtu u rikonstruktua KMK shpk duke i dhënë një zgjidhje afatgjatë problemit, si pjesë e rikonstruksionit të disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë faza II, në muajin Prill 2021 me vlerë 11.18 milion lekë. *Ky prioritet është realizuar plotësisht nga bashkia Vlorë.*

Ndërsa theksojmë se ende nuk janë mbështetur me investime, prioritetet e mëposhtme:

Lagjia pas kopshtit Nr 10 – Prioritet i adresuar pjesërisht, gatë diskutimit të prioritetëve të Kontratës Sociale me staf të Bashkisë u theksua se është përgatitur projekti për rikonstruksionin e kësaj lagje dhe po punohet për të gjetur financim. Gjithashtu edhe rruga “Jani Kosta” (në hartë mban emrin “Jani Rexha”) – nuk ka patur ndërhyrje. Ndërsa *rrugët tek fusha e aviacionit*, sipas referimeve të Bashkisë, do të jetë pjesë e rikualifikimit pasi të largohet venddepozitimi i mbetjeve urbane. *Ky prioritet ende nuk është realizuar.*

Në lidhje me vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe/ose vertikale në zonat ku mungon, gjatë kësaj periudhe ka patur rikonstruksione në disa rrugë të qytetit ku është vendosur njëkohësisht edhe sinjalistika. Sektori i shërbimeve dhe rrugë-trotuareve ka ndërhyrë pjesërisht në vendet ku janë dëmtuar trotualet dhe kanë vendosur sinjalistikën vertikale përmes tabelave në disa nga rrugët e qytetit, ndërsa janë vijëzuar edhe disa nga rrugët kryesore në qytet, duke përmendur ato të rrugës Demokracia, rreth rrotullimi pranë shkollës së Aviacionit dhe ai pranë Pusit të Mezin. Kryesisht janë bërë gjatë 2021 vijëzimet për transportin urban dhe për këmbësorët. *Prioritet i adresuar pjesërisht.*

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është nga 50% në vitin e parë të monitorimit në 70%+ në vitin e dytë të monitorimit, periudha shtator 2020-shtator2021 (nga 10 indikatorë janë përfunduar 7). Prioritet i adresuar pjesërisht.

Novoselë. Ka nevojë për ndërhyrje urgjente në rrugët kryesore në fshatrat: Trevllazër, Cerkovinë, Skrofotinë, si dhe rruga e varrezave Cerkovinë.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Gjatë vitit 2021 janë mbyllur punimet për projektin, “Rehabilitimit dhe Riasfaltimit të Rrugëve Cerkovinë - Skrofotinë – Trevllazër”, duke përfunduar një prej prioriteteve të Kontratës Sociale **Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 100% dhe është prioritet i realizuar.**

Pas riasfaltimit të fshtrove kryesore, gjatë kësaj periudhe kanë vazhduar investimet në fshatrat e tjerë të Nj.A Novoselë. Bashkia Vlorë ka tenderuar rikonstruktimin nga lagjia e Marinajt deri tek kisha e Poros, me vlerë 4 mln lekë. Ndërsa nga Këshilli i Qarkut Vlorë është përfituar një investim me vlerë 28 mln lekë që do të shkojnë për rikonstruksionin e rrugëve të brendshme të fshatit Bishan.

Orikum. I nevojshëm rikonstruksioni i rrugës tek Kisha e Marmiroit, rrugës buzë detit, rrëza e kanalit Dukat, rrugët e brendshme në Tragjas. Zgjerim i rrugëve të Radhimës dhe të Thilpetit.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Nga lista e indikatorëve për ndërhyrje në Nj.A Orikum, është futur në buxhetin e 2021, sistemim-asfaltim i rrugës Orikum-Kisha e Marmiroit me një parashikim prej 105,000 lekë. Por bashkia Vlorë është në kërkim të donatorëve për këtë rrugë, për shkak të fondit të madh që kërkon për realizimin e saj. Në Orikum është parashikuar ndërhyrje vetëm në një rrugë që mban emrin “Gjergj Kastrioti”, ndërsa bashkia deri në shtator të 2021, ishte duke përgatitur dokumentat për rikonstruksionin e rrugës hyrëse me fondi limit: 3,937,500 lekë pa tvsh.

Rruga buzë detit është bërë pjesërisht, gjatë fushatës zgjedhore vetëm njëra anë ndërsa duhet përfunduar edhe segmenti tjetër deri tek postblloku i vjetër. Ndërsa rruga lidhëse e Tragjasit është përfunduar, por nevojitet edhe zgjerimi i rrugës së Radhimës. Pastrimi i i kanaleve në Tragjas, Dukat dhe Radhimë është një proces që po realizohet.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është nga 10% në 30% për periudhën e dytë të monitorimit dhe është prioritet i përfunduar.

Qendër Vlorë. Kërkohet ndërhyrje urgjente në rruget lidhëse të Bestrovës, Kërkovës, Hoshtimës, Sherishtës, Babicë e Vogël dhe Xhyherinës.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Është realizuar rikonstrukcioni i rrugës Panaja – Hoshtimë. Punimet janë realizuar nga Avduli shpk, sipas kontratës së lidhur më datë 06.04.2021 me vlerë 15,547,968 lekë dhe kohëzgjatje 15 ditë dhe punimet në rrugën Panaja – Hoshtimë kanë përfunduar në Prill 2021.

Rruga Babicë e Vogël - Xhyherinë është realizuar. Për rehabilitimin dhe riasfaltimin e rrugës Babicë – Xhyherinë është lidhur kontrata, më datë 15.10.2020, me “Caushi M” shpk - “2N” shpk - “PEVLAKU” shpk, me vlerë 16,229,622 lekë, kohëzgjatja 1 muaj.

Rruga e Sherishtës që përfshihet në “Rikualifikim urban në Njësinë Administrative Qendër (Nartë + Sherishtë)”, me fond limit 8,765,833 lekë pa TVSH është prokuruar nga bashkia Vlorë më 25.06.2021 dhe afati i realizimit të punimeve është dy muaj.

Ndërsa mbeten të adresohen rruga lidhëse midis Bestrovës-Kërkovës, e cila është edhe një prioritet për të cilin banorët e zonës kanë nënshkruar një peticion, të lehtësuar nga VYC.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 70% dhe është prioritet i adresuar pjesërisht (Prioritete të buxhetuar dhe prioritet i prokuruar).

Shushicë. Kërkohet rikonstrukcion i rrugës Shushicë-Beshisht, rrugës së varrezave në fshatin Drithas dhe rrugës kryesore në Shushicë.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Është përfunduar rikonstrukcion i rrugës Shushicë-Beshisht. Në 12.05.2021 është lidhur kontrata me subjektet "AVDULI" - "A.L-ASFALT" shpk për rehabilitimin dhe riasfaltimin e rrugës Llakatund – Beshisht, në më vlerë 57,142,175 lekë dhe kohëzgjatja 1 muaj. Gjatë punimeve, plani i rrugës ka devijuar dhe për këtë arsye në datën 25 Maj 2021 ka patur një protestë të banorëve të fshatrave Llakatund, Beshisht dhe Mekat. Pas takimeve me bashkinë Vlorë dhe banorët, punimet e rrugës Llakatund-Beshisht kanë vazhduar normalisht. Rikonstrukcioni ka përfunduar në muajin korrik 2021, duke përmirësuar aksesin e banorëve të kësaj njësie.

Rruga e varrezave në fshatin Drithas është rikonstruktuar, nga Beqiri shpk me të cilin bashkia Vlorë ka lidhur kontratën me vlerë 1.54 milion lekë dhe kohëzgjatje 15 ditë.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 80% nga 50%+ periudhën e parë të monitorimit në dhe është prioritet i adresuar pjesërisht (Prioritet i prokuruar dhe i realizuar)

PRIORITET NR. 2: FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM

- Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë:

Për rajonet e qytetit Vlorë. Furnizimi me ujë në zonat ku aktualisht ka ujë vetëm një herë në 24 orë. Përmirësim i cilësisë së ujit të pijshëm.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Ndërhyrja për adresimin e kësaj problematike, gjatë vitit 2020-2021, ka qënë në fokusin e punës së bashkisë Vlorë, që e mbështetur nga qeverisja qendrore, ka adresuar projekte konkrete për furnizimin me ujë të Vlorës, duke ofruar ndërhyrje që presin të ndryshojnë situatën për vitet në vazhdim. Në baze të raportit të monitorimit për periudhën 2019-2020, dy projekte madhore janë prokuruar dhe kanë filluar në qytet që janë: Bashkia Vlorë, me financim të Buxhetit të Shtetit po realizon "Projektin Zbatimi për Ujësjiellësin Zona e Ujit të Ftohtë dhe Lungo Mares- Rrapi Uji i Ftohtë – Shkolla e Marinës" dhe projekti tjetër "Ndërtimi i Ujësjiellësit në Rrugën Transballkanike". Të dy projektet parashikojnë ndërhyrje afatëgjata që do të përmirësojnë ndjeshëm situatën. Gjatë periudhës parazgjedhore mjaft projekte janë prezantuar te qytetarët, por edhe janë prokuruar për të ofruar zgjidhje konkrete në zonat problematike të Vlorës që prej vitesh vuajnë mungesën e ujit të pijshëm. Më poshtë po listojmë disa prej projekteve që ndërhyjnë përfundimisht duke ofruar zgjidhje për furnizimin me ujë të pijshëm.

Me fonde nga Buxheti i Shtetit në dhjetor të 2020 është miratuar "Përmirësimet e sistemit me ujë në lagjet ish-fabrika e Çimentos-Partizani-Karabash, dhe rindërtimi i ujësjiellësit në Babicë të vogël, njësia administrative Qëndër Vlorë" miratuar me vendim të Keshillit Teknik të AKUM Nr.67 date 18.12.2020". Ky objekt është parashikuar në buxhetin 2021-2024. Për përmirësimin e sistemit furnizimin me ujë të pijshëm në lagjet ish-fabrika e Çimentos-Partizani-Karabash, dhe rindërtimi i ujësjiellësit në Babicë të vogël, njësia administrative Qëndër, bashkia Vlorë, përmes institucionit prokurues Sh.A Ujësjiellës Kanalizime Vlorë ka kryer procedurën e tenderimit dhe në datën 26.02.2021 është shpallur fituesi "AGBES KONSTRUKSION" SHPK - "LALA" SHPK. Kontrata ka vlerën pa TVSH 244,854,905 lekë dhe kohëzgjatje 12 muaj. Sipas përfaqësuesve të këtij institucioni kontrata për këtë objekt është lidhur më datë 2 prill 2021 dhe punimet priten të mbarojnë në vitin 2022. Një event publik para zgjedhjeve ka lançuar projektin në një prej zonave më problematike të evidentuar nga qytetarët, në lagjen Partizani që prej vitesh vuan mungesën e furnizimit me ujë. Pritet që me mbarimin e investimit të zgjidhen problematikat e furnizimit me ujë të zonave.

Me financim të Qeverisë Shqiptare ka patur ndërhyrje në lagjet "Kushtrimi" dhe "11 Janari", realizuar nga subjekti Shkëlqimi 07. Punimet kanë përfunduar në muajin Maj dhe në bashkëpunim me Ndërmarrjen e Ujësjiellës Kanalizimeve është realizuar lidhja e abonentëve familjarë me rrjetin e ri. Nga investimi në të dy lagjet kanë përfituar rreth 600 familje.

Në lidhje me sigurinë dhe pastërtinë e ujit qytetin e Vlorës çdo ditë monitorohet cilësia e ujit të pijshëm, nga Njësia e Shëndetit Publik. Kontrolli bëhet në 22 pika ku ekzaminohen parametrat kryesorë të ujit të pijshëm, përmbajtja e përqindjes së klorit rezidual në ujë dhe ngarkesa bakteriale MPN. Përcaktohet cilësia dhe siguria për konsum të ujit. Gjithsesi në qytet pjesa më e madhe e

banorëve nuk e konsumojnë ujin e rubinetit si ujë të pijshëm. Edhe në linjat e furnizimit ujë 24 orë, gjatë verës ka patur avari të shumta duke e bërë ujin të pa konsumueshëm.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 70%+ nga 50%+ dhe është prioritet i adresuar pjesërisht (Prioritete të prokurara), ndërsa projektet e planifikuara nuk mbulojnë gjithë zonat që aktualisht kanë nevojë për përmirësim të këtij shërbimi.

Novoselë. *Ndërhyrje në rrjetin e amortizuar që krijon probleme me furnizimin veçanërisht gjatë verës.*

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Si një problem i mbartur prej vitesh, Bashkia Vlorë ka identifikuar një projekt madhor që pritet të ndryshojë situatën në Nj.A Novoselë. E ndihmuar drejtëpërdrejtë nga Qeverisja Qëndrore, Bashkia Vlorë gjatë vitit të parë të monitorimit pasi aprovoi me VKB listën e prioriteteve për ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësive të 15 fshatrave të zonës prioritare të ka tenderuar shërbimin e konsulencës për “Rikonstrukcionin e Ujësjellësit në Nj.A. Novoselë” ku përfshihen 15 fshatra, për përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë nga UK Sh.a. Vlorë. Fondi me vlerë rreth 734 milionë lekë do të përdoret për rikonstrukcionin e linjave të dërgimit dhe shpërndarjes të ujit të pijshëm, depon grumbulluese deri në instalimin e matësve për abonentët. Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Mbetjeve (AKUM) për vitin 2021 ka parashikuar fondin me vlerë 176 milionë lekë, kurse diferenca do të parashikohet në buxhetin e viteve 2022 – 2024. Në projektin e ri punimet do të përfshijnë zëvendësimin e pompave ekzistuese për 7 puset më të reja dhe të tubove të vjetra të dërgimit në rezervuarin grumbullues qendror; zëvendësimin e linjave të ujësjellësit për 15 fshatrat; përmirësimin e rrjetit shpërndarës për lagjet e reja dhe do të instalohen rreth 4,180 matës të ujit për të gjithë fshatrat e zonës të Novoselës.

Nga Bashkia e Vlorës është hapur gara për punimet në vitin e parë të investimit me vlerë 176 milionë lekë. Për rikonstrukcionin e ujësjellësit në fshatrat e Njësisë Administrative Novoselë, më datë 12.01.2021 është shpallur procedura e tenderimit me vlerë 733.93 milion lekë dhe kohëzgjatje 18 muaj. Në 21.05.2021 është shpallur shpallur fituesi “GENER 2” & “Rroku GUEST” shpk me vlerën 729,294,746 lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur më datë 21 qershor 2021 dhe pritet që punimet të ndryshojnë gjendjen problematike të kësaj Nj.A. Ndërsa përfundimi i punimeve është parashikuar 2024.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 60% nga 20%+ në raportin e periudhës së parë të monitorimit dhe të prioritet i adresuar (Studim fizibiliteti, mbeshteje financiare nga AKUM dhe tenderim e lidhje kontrate nga bashkia)

Orikum. *Me prioritet ndërhyrjet në Dukat të Ri dhe Dukat fshat.*

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Projekti I furnizimit me ujë të pijshëm për fshatrat Dukat-Tragjas-Jonufër-Radhimë, financuar nga FSHZH dhe bashkëfinancim nga bashkia Vlorë, për paisjen me furnizim me ujë të pijshëm 24 orë, është në fazën e finalizimit. Në muajin Maj 2021 është realizuar një investim në ujësjellësin në Dukat të Ri. Investimi ka përfunduar dhe realizon furnizimin me ujë. Nuk kemi të dhëna nëse bashkia Vlorë e ka marrë në dorëzim këtë vepër, por ende dhe sot zona e Nj.A Orikum vazhdon të vuajë mungesën e ujit, që në qytet vjen dy orë në ditë nga 45 minuta. Ndërsa 'Ujësjellës Kanalizime Vlorë sh.a' vazhdon të kërkojë financime për qytetin e Orikumit.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 90%+ dhe është prioritet i adresuar drejt përfundimit.

Qendër Vlorë. Furnizim me ujë për fshatrat Bestrovë, Babicë e Vogël, Hoshtimë, Kërkovë dhe Panaja.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Situata për banorët e fshatrave që presin prej vitesh të furnizohen me ujë është e njëjtë, pa ndryshime konkrete gjatë raportit të dytë të monitorimit. Një zgjidhje provizore ishte ofruar nga ndërmarrja e UK Sh.a Vlorë, duke montuar një pompë të re në Shushicë dhe shtrimin e linjave të reja në Babicë. Gjithësesi ndërhyrjet kanë qënë provizore dhe nuk ka të dhëna për ndryshimin e situatës.

Ndërsa në fshatrat Bestrovë, Hoshëtimë, Kërkovë dhe Panaja, banorët janë mbledhur më datë 26 qershor 2021 në një protestë në fshatin Panaja. Duke qënë se shqetësimet e tyre nuk janë marrë parasysh, një përfaqësi e banorëve nga fshatrat Kërkovë, Oshtimë dhe Panaja e kanë çuar më tej protestën e tyre përpara ambjenteve të bashkisë Vlorë. Në takimet me përfaqësuesit e bashkisë Vlorë, është marrë premtimi se situata do të ndryshojë, ndërsa është ofruar zgjidhje provizore për furnizimin me ujë gjatë verës.

Nga analiza e dokumentacionit të shqyrtuar, aktualisht bashkia Vlorë ka përfshirë fshatrat e mësipërm si pjesë e ndërhyrjes së projektit të rikonstruksionit të rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm për 15 fshatrat e zonës të Novoselës. Në projekt është përfshirë projektimi i një linjë të veçantë për furnizimin me ujë të fshatrave, si: Bishan, Poro, Dëllenje, Delisuf dhe Akerni, Kërkovë, Panaja, Oshëtimë, Cerkovinë dhe Trevllazër, si dhe do të projektohet një stacion i përbashkët shtytës për depot e fshatrave si: Kërkovë, Panaja, Oshëtimë dhe Bestrovë.

Punimet do të përfundojnë në vitin 2024, ndërsa pritet që për zonat e targetuara në këtë prioritet të ndryshojë situata, gjatë vitit të ardhshëm.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 40% në 10% në raportin e parë të monitorimit dhe është prioritet i adresuar (Studim fizibiliteti, mbeshteje financiare nga AKUM, tenderim e lidhje kontrate nga bashkia për pjesën e parë të projektit. Gjithsesi kohët e zbatimit të projektit janë të gjata dhe mbetet të shihet për periudhën 2022-2023 nëse do të ketë ndryshime të situatës)

Shushicë. Furnizim me ujë për fshatrat Llakatund, Beshisht dhe Bunavi, përmirësim i cilësisë së ujit në Drithas dhe Grabian.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Edhe pse në raportin e parë është raportuar që nga ndërmarrja e UK Sh.a Vlorë ka montuar një pompë e re dhe një pus shtesë në Shushicë, për të rritur sasinë e ujit, si dhe ka pastruar depon në Grabian për furnizimin me ujë sa më cilësor, nga raportimet në terren asgjë nuk ka ndryshuar. Banorët vazhdojnë të furnizohen në çezmat kryesore të fshatrave ndërsa uji vazhdon të vijë me orar atje ku janë tubacionet e shtruara.

Fondi Shqiptar I zhvillimiti ka tenderuar “Ndërtimi i Stacionit të Pompimit, tubacioni kryesor dhe rrjetit shpërndarës të ujës-jellës të Grabianit”, por deri më sot situata nuk ka ndryshuar. Banorët edhe pse janë në djeni të një projekti nuk kuptojnë pse bashkia nuk e ka vënë në funksion këtë vepër, ndërsa vazhdojnë të kenë mungesë të ujit të pijshëm. Asnjë progres nuk është vërejtur në periudhën e monitorimit për Nj.A Shushicë.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 20%+ dhe është prioritet i pa realizuar.

PRIORITET NR. 3: KANALIZIMET

- **Përmirësim të cilësisë së kanalizimeve në secilën prej njësive vijuese:**

Rajonet e qytetit Vlorë. Kryerje e investimeve në rrjetin e kanalizimeve në zonat periferike dhe vënia në funksion e impiantit të përpunimit të ujrave të zeza në zonën e bregdetit.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Nisur nga komunikimi zyrtar i realizuar me UK Vlorë Sh.a dhe bashkia Vlorë, vazhdon puna për sistemimin e kanalizimeve të ujërave të zeza dhe ujërave të bardha, përmes disa investimeve madhore të mbështetura nga qeverisja qendrore. Vetë institucioni përgjegjës bën pastrimin dhe mirëmbajtjen ku mund të theksojmë se në periudhën gusht-shtator 2020 është bërë pastrimi i të gjitha kanaleve të ujrave të bardha në qytet dhe shtrimi i një tubacioni, për të ulur pasojat e përmbytjeve në zonat që rezultojnë problematike, siç është zona e Albano dhe Rominës që përmbytet në çdo sezon. Gjithësesi Sh.A UK Vlorë ka realizuar investime në rrjetin e kanalizimeve duke shtruar tubacion korrogato me diametër 400 nga Stacioni i Ujërave të Bardha te Parku i Tregëtisë, me dalje në det duke mundësuar që dy pompat e stacionit të vihen në punë duke mundësuar që ujrart e mbedhura të largohen së bashku me ujrart e shiut. Gjithashtu është shtruar një tjetër tubacion me diametër 500 për të mbledhur ujërat e shiut nga zona e Bibliotekës “Shevqet Musaraj”, deri te Kisha Ortodokse, duke ulur pasojat e përmbytjeve që ndodhnin çdo vit në këtë zonë.

Me fonde nga Buxheti i Shtetit, sipas shkresës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjensia Kombëtare e Ujës-jellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve nr.226 prot. datë 28.01.2021 ka miratuar objektin për programin “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, ku AKUM ka planifikuar dhe

miratuar projekt-zbatimin për “Studim, Projektim i Rrjetit të Kanalizimeve nga Lungomare deri në hyrje të Radhimës, Vlorë” me vlerë të plotë 35 640 000 lekë me TVSH. Ky objekt është miratuar në buxhetin 2021-2024. Është tenderuar nga Bashkia Vlorë, më 16 gusht 2021 me afat realizimi 6 mujor dhe punimet do të kryen përmes firmës “SRP ALBANIAN ENGINEERING” & “I T M” Sh.P.K. Ky projekt do të ndërhyjë në përmirësimin e situatës në zonën bregdetare të Vlorës.

Një tjetër projekt madhor i mbështetur nga qeverisja qendrore përmes bashkisë Vlorë është edhe “Ndërtim KUZ, rrjeti tercial (Lidhjet familjare) për UK Vlorë”. Sh.A Ujësjetës Kanlizime Vlorë, ka tenderuar dhe lidhur kontratën më 5/07/2021 për këtë projekt me firmë fituese “Gener 2” sh.p.k. Financimi do të jetë i shpërndarë në katër vite. Ky objekt është parashikuar në buxhetin e shtetit për likuidim në vitet 2021-2024. Përmes tij pritet të sistemohet sistemi i kanalizimeve në qytetin e Vlorës. Mbetet për tu monitoruar vit pas viti, progresi i këtij projekti.

Duke u nisur nga raportimi i vitit të parë të monitorimit theksojmë se këtë verë ka qënë në funksion të plotë impianti i përpunimit të ujrave të zeza në zonën e bregdetit, duke e kthyer zonën e Lungomares në një plazh të frekuentuar nga pushuesit.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 90%+ dhe është prioritet i realizuar. Mbetet të monitorohet në vazhdim rezultatet që do të sjellin ndërhyrjet e buxhetuara.

Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë dhe Shushicë. Ndërhyrje në sistemin e kanalizimeve, me prioritet në Njësinë Administrative Qendër dhe Shushicë dhe në zonat ku kanalizimet funksionojnë me gropa septike, si dhe specifikisht në fshatrat Mifol dhe Akërnë.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Nuk ka informacione për ndryshim të situatës për vitin e dytë të raportimit, vetëm në KUZ Fitore dhe KUB Novoselë (ujëra të zeza dhe të bardha) janë hartuar projektet që janë pjesë e financimit të projektit të furnizimit me ujë të 15 fshatrave të Novoselës, që pritet të ndërhyet në vitet e ardhshme. Në Orikum po hartohet projekti për KUZ dhe për vënien në punë të impiantit të ujërave të ndotura, financuar nga FSHZH dhe KFV, por ende nuk janë gjetur fonde. Ndërsa për Nj.A Qendrër dhe Shushicë nuk ka rrjet kanalizimesh dhe deri për periudhën e raportimit nuk ka një projekt përfundimtar për ndryshimin e situatës.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 40%+ dhe është prioritet i adresuar pjesërisht.

PRIORITET NR. 4: TRANSPORTI PUBLIK

- **Zgjidhje e problemit të transportit për fëmijët e shkollës në Dukat dhe të shkollës së Sherishtës.**

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Këtij problemi i është dhënë zgjidhje duke i transportuar fëmijët në statusin e pasagjerit në linjë ndërqytetëse që në raportin e parë të monitorimit. Banorët rikonfirmojnë se kjo çështje është e zgjidhur dhe nuk përbën më problem.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 100% dhe është prioritet i realizuar.

PRIORITET NR. 5: TRANSPORTI PUBLIK

- **Shtim i shërbimit të transportit urban dhe në lagjet periferike të qytetit. Orare fikse, linja më të shpeshta transporti dhe rritje e orarit të shërbimit përtej orës 18.00**

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Bashkia e Vlorës ka tenderuar shërbimin e transportit publik në një firmë private që mbulon transportin në qytet. Ky transport ofrohet për të njëjtat linja. Paralelisht, mbi bazën e rregulloreve të reja, nevojitet një operim më i përshtatshëm për të gjithë autobusët ekzistues, futja e një linje tjetër shërbimi për autobusët me qëllim që të mbulohen zonat ku aktualisht nuk ka asnjë shërbim dhe të bëhet një koordinim i mundshëm i ndërlidhjes me operatorët e ndryshëm. Gjithsesi nevojitet mbikëqyrje dhe disiplinim të shërbimeve të transportit publik lokal nga shoqëritë private (miratimi i tarifave për pasagjerët dhe i orëve dhe shpeshtësisë së shërbimeve). Për këtë prioritet situata nuk ka ndryshuar nga raporti i parë. Në Nj.A, banorët shprehen se transporti është zgjidhur përmes linjave private me furgona çdo gjysëm ore. Orari i funksionimit të këtyre linjave është deri në orën 18:00 për kthimin nga Vlora gjatë dimrit dhe 19:00 për kthimin nga Vlora gjatë verës. Ka nevojë për zgjatje të orarit, sidomos gjatë verës për personat në punë sezonale me orare të vona.

Në lidhje me këtë prioritet progresi është 50% dhe është prioritet i adresuar pjesërisht.

PRIORITET NR. 6: PASTRIMI

- **Të vihet në funksion impianti i venddepozitimit të mbeturinave në Sherishtë.**

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Projekti i ndërtimit të vend-depozitimit të Sherishtës financohet nga Qeveria Gjermane nëpërmjet Bankës Gjermane për Zhvillim KfW. Kapaciteti i venddepozitimit është rreth 1,000,000 m³ (4 qelizat) i projektuar për një periudhë 20 vjeçare, çka përputhet edhe me përvoja bashkëkohore në këtë fushë, e vendeve më të zhvilluara. Në kuadër të projektit po ndërtohen qelizat 1 dhe 2 me kapacitet rreth 500,000 m³ me periudhë shfrytëzimi deri në 15 vjet. Impaniti i venddepozitimit është pjesë e programit të menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane në Vlorë. Programi përbëhet nga tre komponentë që janë:

1. Ndërtimi i qendrës së menaxhimit të mbetjeve urbane (përfshirë venddepozitimin) në afërsi të fshatit Sherishtë (komponenti i parë është aktualisht në zbatim është përfunduar 70% e punimeve), me komponentët komplementarë të venddepozitimit sipas kuadrit ligjor dhe standarteve të BE-së. Komponenti i parë përfshin “Projektin e ndërtimit të qendrës së menaxhimit të mbetjeve duke përfshirë landfillin, impiantin e ndarjes dhe selektimit të mbetjeve, impiantin e trajtimit të ujrave të ndotura që gjenerohen nga mbetjet, godinën administrative të ndërmarjes që do menaxhojë qendrën e mbetjeve, magazinën, me vendndodhje në Sherishtë” i cili është investimi i parë

infrastrukturor në fushën e trajtimit të mbetjeve urbane në Vlorë dhe punimet kanë nisur në Korrik 2020 dhe parashikohet të përfundojnë në fillim të vitit 2022. Në këtë fazë kemi gjithashtu ndërtimin e garazhdit bashkiak për mjetet e reja të pastrimit të qytetit i cili po ndërtohet pranë fushës aktuale të mbetjeve, instalimin e koshave të nëndheshëm në zonën turistike të qytetit “Lungomare” dhe rehabilitimin e pikave të koshave në të gjithë territorin e Bashkisë.

2. Blerjen e makinerive dhe paisjeve për pastrimin e qytetit (komponenti 2). Menaxhimi i infrastrukturës së re që po ndërtohet duke përfshirë komponentin e dytë të projektit që ka nisur zbatimin në muajin shtator 2021 me sistemin e ri të mjeteve për grumbullimin e mbetjeve duke përfshirë koshat dhe makineritë e transportit do të administrohen nga Ndërmarja Bashkiake e krijuar rishtaz me mbështetjen e projektit. Në këtë kuadër me mbështetjen e konsulentëve gjermane po hartohet plani i biznesit ku përfshihen edhe tarifat për shërbimin e mbetjeve.

3. Rehabilitimin e vend depozitimeve ekzistuese të rajonit të Vlorës. Komponenti i tretë i projektit përfshin rehabilitimin e dy fushave të mbetjeve Vlorë dhe Orikum si dhe 10 pikave të tjera të cilat janë përdorur për grumbullim mbetjesh në njësitë administrative. Duke kapsuluar mbetjet dhe kthyer gjithë zonën në një mjedis të gjelbër me lulishte dhe pemë. Gjithashtu ndërtimin e fabrikës së kompostimit për mbetjet organike. Në këto momente bashkia referon se ndodhet në fazën e projektimit dhe pritet zbatimi i këtij projekti në mesin e vitit 2022 sipas standarteve dhe direktivave europiane.

Në shtator 2020, kryebashkiaku Dritan Leli inspektoi nga afër punimet e kryera për landfillin e Sherishtës duke garantuar që puna do të mbarojë brenda vitit 2021, ndërsa përfituese e drejtpërdrejtë përsa i përket menaxhimit të mbetjeve urbane pritet të jenë Bashkia Vlorë dhe Bashkia Selenicë.

Ndërsa në muajin tetor 2020, Kryeministri Rama tregon mbi progresin e punimeve në këtë zonë për landfillin e Sherishtës, me një kapacitet prej 350 tonë mbetjesh, duke theksuar se ndërhyrja parashikon në fazën e dytë dhe kapsulimin e landfillit ekzistues. Ndërsa një grup arkeologësh ka ngritur pretendime për ekzistencën e një qytetërimi antik në këtë zonë. Në lidhje me këtë çështje bashkia Vlorë ka lidhur aktmarrëveshje për ndjekjen periodike ditore të procesit të gërmimit dhe u shpreh se ekspertët arkeologë sipas detyrimit ligjor janë prezentë gjatë gërmimeve në kantier. Në 16 qershor 2021, sipas kryebashkiakut Dritan Leli, ka përfunduar rreth 50 % e punës për ndërtimin e Qendrës së Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane. Në mbledhjen e KB të datës 30.09.2021 ishte parashikuar në pikën nr 6 “Miratimi i P/V për një shtesë strukture në mumrin e fuqisë punëtore dhe shtesë fondi në ndërmarrjen publike bashkiake për menaxhimin e mbetjeve urbane të bashkisë Vlorë”. KB i Vlorës e hoqi nga rendi i ditës duke e shtyrë aprovimin e këtij vendimi. Në bazë të marrëshveshjes me KFV- në bashkia Vlorë duhet të mbështesë ndërmarrjen publike bashkiake për menaxhimin e mbetjeve urbane përmes bashkëfinancimit të saj përmes mbështetjes me fonde dhe staf për prioritetin nr 6 te Kontratës Sociale, që përkon me përfundimin e punimeve të Landfillit të Sherishtës.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 80%+ dhe është prioritet i adresuar drejt realizimit faktik.

PRIORITET NR. 7: PASTRIMI

- Përmirësim i cilësisë së pastrimit sipas nevojave të secilës njësi:

Rajonet e qytetit Vlorë. Shërbim cilësor dhe shtimi i koshave në disa zona të qytetit, sidomos gjatë sezonit turistik. Pastrim nga inertet në rrugët ku ka pasur rikonstrukcion (p.sh rruga “Shyqyri Alimerko”). Në pjesën e “Lungo Mares” i domosdoshëm shtimi i koshave sidomos në rrugët dytësore që dalin në të. Të shtohen masat e kontrollit të Bashkisë në zonat ku banorët bëjnë djegie të mbetjeve kryesisht plastikave, veçanërisht në ish-fushën e druve dhe ish-fushën e aviacionit.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Në qytetin e Vlorës operon kompania “Duka”shpk, që ofron sigurimin e nevojshëm të koshave dhe kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve, duke garantuar edhe mirëmbajtjen e tyre, me synimin që në qendër të qytetit të bëhet i mundur klasifikimi i mbeturinave. Në zona të caktuara sipas grafikut të miratuar nga bashkia dhe sidomos gjatë sezonit turistik largohen mbeturinat 2 herë në ditë. Firma kontraktuese ofron ngarkim, transport mbeturina me 140 ton/ditë dhe sistem i mbeturinave në fushën e depozitimit (140 ton/ditë). Kontrata për pastrimin e qytetit me shoqërinë “Duka” është trevjeçare me një fond prej 698022984 lekë me tvsh dhe është fond që sigurohet nga të ardhurat e bashkisë. Në qytet janë 1050 kontenierë, të shpërndarë në 390 pika grumbullimi. Rreth 1/3 e mbetjeve janë mbetje të papranueshme që përbëhen kryesisht nga inertet. Për këtë qëllim jo vetëm pikat e identifikuar nga Kontrata Sociale por edhe pika të tjera në qytet si tek shkolla 28 Nëntori, lagjia Lirim, Pusi i Mezinit, në Transballkanike që janë identifikuar si vende ku janë depozituar mbetje interte që janë pastruar. Deri në shtator 2021, vazhdon të mbetet shqetësim depozitimi i mbetjeve inerte në zonën e Pyllit të Sodës, që edhe pas pastrimit janë mbushur prapë me mbetje inerte. Në këtë proces nevojitet që edhe Policia Bashkiake të riformatojë punën e saj për të mos lejuar depozitimin e inerteve në pika të caktuara të qytetit.

Përsa i përket djegieve të mbeturinave, është një aktivitet që kryhet rregullisht në fushën e Aviacionit, që sjell ndikime në jetën e banorëve të zonës përreth, por edhe të turistëve që frekuentojnë Vlorën gjatë verës. Fenomeni është më i ndjeshëm në periudhën e verës, edhe pse nga institucioni i bashkisë vazhdon të monitorojë procesin dhe të koordinojë punën me firmën “Duka” për eliminimin e situatave ku mund të ketë zjarrëvënie të qëllimshme në fushën provizore të mbeturinave.

Në zbatim të Urdhërit të Brendshëm të Kryetarit Bashkisë Nr.195, datë 30.07.2021 ‘Mbi marrjen e masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në territorin e Bashkisë Vlorë ’ nga policia bashkiake doli Urdheri I Brendshëm për monitorimin e gjithë territorit të Bashkisë me shërbime policore 24 orë, për të kostatuar dhe ndërhyrë në cdo rast zjarri. Nga data 30.07.2021 e në vazhdim mbulohet me shërbim 24 orë për të eliminuar çdo rast të rënies së zjarrit në pikën e grumbullimit të mbetjeve urbane. Gjithësesi zgjidhja e gjithë çështjeve që përmban ky prioritet mbetet funksionimi i venddepozitimit të Sherishtës që do të zgjidhë njëherë e mirë këto problematika.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 80%+ dhe është prioritet i realizuar.

Novoselë. Vendosija e koshave për mbledhjen e mbeturinave në çdo fshat. Nevojitet të shtohen 140 kosha të tjerë.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Bashkia Vlorë ka lidhur kontratën nr.6483 prot datë 30.07.2020 me shoqërinë “REJ” sh.p.k. me objekt “Shërbimi i pastrimit të Njësive Administrative Qendër, Novoselë, Shushicë të Bashkisë Vlorë”, që ka filluar nga zbatimi më datë 01.08.2020, me afat 32 muaj.

Pastrimi urban në Nj.A Novoselë, për periudhën e monitorimit, në bazë të kontratës së re konsiston në: 1: Heqja dhe transporti i mbeturinave urbane në vendin e hedhjes së caktuar, çdo 3 ditë në javë, ose 10 herë në muaj. 2: Punëtorët e pastrimit kanë për detyrë të heqin mbeturinat e lokaleve dhe familjeve që ndodhen në fshatrat e Njesisë Administrative Novoselë. Pas ngarkimit të mbeturinave në makina do të kryhet transporti i tyre në pikën e hedhjes së mbeturinave të caktuar. Pastrimi dhe transporti i mbeturinave bëhet 3 ditë në javë. 3: Njësia Administrative Novoselë ka të instaluar në total 43 konteniere dhe 53 pika të tjera në hapësirën e 12 fshatrave. Përsa i përket kontenierëve të rinj, ende nuk janë vendosur, përgjatë periudhës së monitorimit shërbimi i pastrimit është mbuluar me të njëjtët konteniere ose vende të caktuara për depozitim.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 30+ dhe është prioritet i pa realizuar.

Orikum. Vendosije e koshave në lagjet brenda fshatrave dhe dezinfektimi i koshave ekzistues. Eliminimi i plotë i djegies së plehrave.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Pastrimi i Njesisë Administrative Orikum realizohet nga firma “Baitel” sh.p.k. që ka fituar tenderin 3-vjeçar me një fond prej 78 941 978 lekë. Gjatë një viti financiar kjo firmë realizon: Ngarkim, transport mbeturina 10 ton në ditë në total 3650t/vit, duke përfshirë edhe mbetjet inerte; Fshirje manuale dhe me makineri të rrugëve; Sistemim i mbeturinave në fushën e grumbullimit duke përfshirë edhe mbetjet inerte; larje të rrugëve me ujë.

Gjithsesi qytetarët e njësisë administrative Orikum vazhdojnë të kenë shqetësime në lidhje cilësinë e pastrimit në qytet, që ka nevojë të përmirësohet. Gjithashtu ka nevojë të dezinfektohen të gjithë kazanët e mbeturinave, ndërkohë që dezinfektohen vetëm disa prej tyre në qendër të qytetit. Kërkohej që gjatë verës koshat të zhvendosen nga rruga kryesore sepse bëhen burim infeksionesh. Gjithashtu kërkohej edhe shtimi i tyre, në bregdet, për shkak të shtimit të popullsisë gjatë verës.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 20% + dhe është prioritet i pa realizuar.

Qendër Vlorë. Bashkia të kontraktojë firmë pastrimi ose nëpërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike te vendosë kosha për mbledhjen e mbeturinave në të gjitha fshatrat. Mbledhja sistematike e mbeturinave nga makinat e pastrimit në të gjitha fshatrat e kësaj njësie.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Siç shpejguam më lart Bashkia Vlorë ka lidhur kontratën me shoqërinë “REJ” sh.p.k. me objekt “Shërbimi i pastrimit të Njësive Administrative Qendër”, që ka filluar nga zbatimi më datë 01.08.2020. Firma e pastrimit për të këtë Nj.A mbulon: Heqjen dhe transportin e mbeturinave urbane në vendin e hedhjes së caktuar 10 herë në muaj. Ndërsa punëtorët e pastrimit kanë për detyrë të heqin mbeturinat e lokaleve, hoteleve dhe familjeve që ndodhen përgjatë bregdetit të Nartë-Zvërnec. Pas ngarkimit të mbeturinave në makina realizohet transporti i tyre në pikën e hedhjes së mbeturinave të caktuar nga Njësia Qendër. Pastrimi dhe transporti i mbeturinave bëhet 3 ditë në javë në të 13 fshatrat e kësaj Nj.A edhe pse distancat e secilit fshat nga pika e grumbullimit të mbeturinave në Vlore janë të largëta, gjithësesi banorët shprehen të kënaqur që pas kaq kohësh ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave. Ndërsa në Nartë kërkohet shërbim më cilësor nga firma e kontraktuar për shkak edhe të sezonit turistik. Aktualisht nuk ka kosha të rinj për këtë njësi, ndërsa realizohet periodikisht mbledhja e mbeturinave.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 40% dhe është prioritet në progres për tu realizuar.

***Shushicë.** Urgjente shtimi i koshave të mbetjeve në të gjithë njësinë. Prioritet pastrimi në fshatrat Risili, Çeprat, Mekat, Bunavi, Beshisht dhe Drithas.*

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Heqja dhe transporti i mbeturinave urbane në vendin e hedhjes së caktuar, realizohet nga firma e kontraktuar prej gushtit të 2020, 3 ditë në javë, ndërsa punëtorët e pastrimit sipas bashkisë heqin mbeturinat e lokaleve dhe familjeve që ndodhen në fshatrat e Njësive Administrative Shushicë. Pas ngarkimit të mbeturinave në makina do të kryhet transporti i tyre në pikën e hedhjes të caktuar së mbeturinave 10 herë në muaj. Bashkia Vlorë e ka kontraktuar këtë shërbim me qëllim ofrimin e shërbimit sa më të mirë për banorët e kësaj njësie. Duke qënë në vitin e parë të zbatimit të kontratës nuk është monitoruar drejtëprdrejtë cilësia e shërbimeve që ofron firma, por qytetarët të pyetur, vlerësojnë faktin që ka një shërbim që ofrohet.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 40% dhe është prioritet në progres për tu realizuar.

PRIORITET NR. 8: ZHVILLIM EKONOMIK

- **Zhvillim i programeve për mbështetjen e fermerëve, si dhe përfundim i procesit të menaxhimit të tokave.**

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Prej shtatorit të 2020, pranë bashkisë Vlorë është vendosur një nën/kryetare që realizon punën e saj të përditshme për sektorin e bujqësisë. Si një sektor mjaft i rëndësishëm së bashku me kryetarin

e bashkisë, gjatë shtator-tetorit të 2020, mjaft banorë të Nj.A u asistuan në takime dhe degjese publike për problemet në sektorin e bujqësisë, por edhe u promovuan raste pozitive të fermerëve lokale. Nga monitorimi vihet re një vëmendje e shtuar, duke asistuar fermerët lokale me informacione rreth kulturave bujqësore dhe varieteteve të ndryshme që janë mbështetur nga Bashkia Vlorë.

Edhe pse bashkia Vlorë për momentin nuk ka ngritur shërbime të mirëfillta për fermerët, ajo funksionon si ndërmjetësuese e shërbimeve për fermerët duke lehtësuar ndjeshëm informacionin dhe asistencën për programet kombëtare të AZHBR-së ose Ministrisë së Bujqësisë, mban marrëdhënie me Agropikën dhe institucione të tjera dhe ofron informacion mbi aplikimet për mbështetjen e sektorit bujqësor. Gjithashtu për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar, bashkia Vlorë lehtëson procedurat për aplikuesit nga territori i saj. Nga komunikimet me qytetarët në Nj.A janë marrë vlerësime pozitive për mbështetjen dhe ndërmjetësimin e ofruar në nivel kombëtar apo ndërkombëtar të modeleve pozitive që ekzistojnë në territor nga udhëheqësit e Bashkisë Vlorë.

Ndërsa në lidhje me përfundimin e procesit të menaxhimit të tokave, vazhdohet të ecet me ritme të ulta, edhe pse nevojat vazhdojnë të jenë të larta nga qytetarët. Përshpejtimi i këtij procesi ndikon edhe në programin e mbështetjes së fermerëve, të cilët mund të aplikojnë për mbështetje nga fondet e AZHBR-së për mbështetje financiare.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 70%+ nga 50% ne raportin e parw tw monitorimit dhe është prioritet i adresuar.

PRIORITET NR. 9: ZHVILLIM EKONOMIK

- **Zhvillimi i një mekanizmi efektiv nga Bashkia për mbledhjen e taksave ku të përfshihen edhe fushata informimi e komunikimi me komunitetin mbi mbledhjen dhe rishpërndarjen e tyre.**

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Nga ana e bashkisë Vlorë, për progresin e vitit të dytë të monitorimit janë vënë re aksione pozitive nga drejtoria përkatëse në funksion të informimit dhe bashkëpunimit të komunitetit për mbledhjen e taksave. Gjithësesi nga ana e bashkisë janë informuar derë me derë subjektet ekonomike, ndërsa për qytetarët nuk janë shpërndarë njoftime. Njoftimi përmes postës elektronike për detyrimet ndaj Bashkisë ishte një masë që dha efekt për subjektet e ndryshëm, ndërsa mund të aplikohet edhe për qytetarët ose kryefamiljarët që paguajnë taksa për periudhat në vazhdim. Rekomandojmë se duhen gjetur forma alternative të njoftimit dhe këshillimit me qytetarët, duke rritur arkëtimet, por duke marrë mbrapsh edhe shërbime cilësore në komunitet. Gjithashtu postimet të mediat sociale dhe lokale duhet të mbështeten për të informuar qytetarët për pagesat e taksave dhe tarifave.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 40%+ dhe është prioritet i pa realizuar

PRIORITET NR. 10: ZHVILLIM EKONOMIK

- **Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për të rinjtë dhe gratë.**

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Gjatë monitorimit të periudhës së dytë, në datë 01.10.2020, me vendim të KB, bashkia e Vlorës lidhi marrëveshjen e bashkëpunimit mes shoqatës Bashkimit të Biznesit të Shqipërisë - Biznes Albania “Për funksionimin e laboratorit të turizmit (SET-TOUR LAB)”, duke miratuar fondin prej 9,697,779 lekë si pjesë e bashkëfinancimit nga ana e bashkisë Vlorë, për realizimin e trajnimeve në Laboratorin e Turizmit. Përmes këtij financimi, bashkia synon të kalohet në veprime konkrete për vënien në funksion të laboratorit të turizmit si një akademi e rëndësishme e trajnimeve në sektorin e turizmit për recepsionist, kamarier, menaxher, guidë turistike barist, etj për ti dhënë një shtysë zhvillimit të kualifikimeve në këtë sektor. Prej marsit të 2021, laboratori ka njoftuar të rinjtë/gratë që duan të punësohen në sektorin e turizmit që mund të përfitojnë nga kurset e trajnimit falas që ofrohen pranë ambienteve të tij. Në këtë mënyrë bashkia Vlorë mbështet formimin dhe mundësive për të rinjtë e gratë.

Ndërsa për aftësimin e grave nga Njësitë Administrative të Vlorës, bashkia financon udhëtimin e tyre për trajnim pranë Qendrës së Formimit Profesional me një fond në dispozicion prej 980.000 lekë organizatën Me Komunitetin për Ndryshim.

Mbetet për tu monitoruar në vazhdimësi mbi numrin e përfituesve që përfitojnë nga ky shërbim.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 60%+ dhe është prioritet i realizuar.

PRIORITET NR. 11: DEMOKRACIA VENDORE

Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv (Buxhetimi me Pjesëmarrje) për të marrë këndvështrimin e komunitetit mbi vendimarrjet më të rëndësishme, duke:

- *mos u limituar vetëm tek konsultimi i buxhetit por dhe mbledhje të nevojave të qytetarëve;*
- *përdorur edhe forma të tjera konsultimi përveç takimeve me komunitetin, si dhe duke rritur numrin e takimeve konsultuese;*
- *mundësuar përfshirjen e gjerë të komunitetit në këto procese;*
- *raportuar sistematikisht në komunitetet se sa prej mendimeve të komunitetit janë reflektuar në vendimarrjet e saj.*

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Bashkia Vlorë vlerësohet pozitivisht për realizimin e procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje. Ajo ka përmirësuar implementimin e procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje. duke zhvilluar dëgjesa të hapura të dokumentuara me regjistrime dhe publikime në mediat sociale dhe lokale, ndërsa vazhdon të konsolidojë efektivitetin e këtij mekanizmi. Gjithsesi vlen të përmendet fakti që ka përfshirje dhe reagim qytetar gjatë dëgjesave të realizuara përgjatë periudhës tetor-dhjetor 2020.

Bashkia e asistuar edhe nga organizata lokale, përdor edhe metoda të mbledhjes së perceptimeve dhe prioriteteve online, përmes anketimit të qytetarëve. Për vitin 2020 rreth 1210 qytetarë vlerësuan online duke përfshirë një pjesë të mirë të prioriteteve të Kontratës Sociale në buxhetin vendor.

Mbetet ende për të bërë, lidhur me detyrimet ligjore për zbatimin e ligjit të njoftimit dhe konsultimit publik, gjithsesi vlerësohet si progres pozitiv realizimi i këtij prioriteti.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 90%+ dhe është prioritet i realizuar

PRIORITET NR.12: DEMOKRACIA VENDORE

- **Të krijohet Këshilli Rinor Vendor për të rritur pjesmarrjen e të rinjve në vendimarrjen lokale.**

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, Neni 9 “Të drejtat e njësive të qeverisjes vendore”, pika d) Krijojnë komitete, borde ose komisione për kryerjen e funksioneve të veçanta sa herë që paraqitet nevoja, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore dhe Neni 16 “Konsultimi publik në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 1) Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes, në vullnetin e tyre të plotë dhe respekt ndaj qytetarëve dhe bazuar mbi Ligjin për Rininë, neni 10, Bashkia e Vlorës ka ngritur Këshillin Vendor të Rinisë, më datë 15 janar 2020, me numër 590, datë 20.01.2020. Kjo strukturë ka nënshkruar një marrëveshje bashkepunimi me Kryetarin e Bashkise dhe kryetaren e Këshillit Bashkiak dhe përfaqësuesve të Këshillit Vendor të Rinisë. Me qëllim që Këshilli Vendor të formalizohej, bazuar edhe në ndryshimet ligjore të Ligjit për Rininë, gjatë periudhës korrik-shtator të rinjtë kanë ndërmarrë një fushatë advokuese për rëndësinë e aprovimit të rregullores së kësaj strukture edhe me vendim të KB apo duke advokuar shërbime më pozitive për të rinjtë në Bashkinë Vlorë.

Në Buxhetin e vitit 2021, Bashkia Vlorë ka planifikuar fonde për realizimin e Planit Lokal dhe iniciativave rinore në total prej 500.000 lekë. Gjithsesi vazhdon ende puna për përfundimin e procedurave të ngritjes dhe funksionimit të Këshillit Vendor të Rinisë.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 60%+ dhe është prioritet drejt realizimit përfundimtar.

Referenca

Faqja zyrtare e bashkisë Vlorë <http://vlora.gov.al/>

Faqja zyrtare e Këshillit të Bashkisë <http://vlora.gov.al/category/degjesat-publike/>

Buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2021 <http://vlora.gov.al/wp-content/uploads/BUXHETI-2021-VENDIM.pdf>

Kontrata Sociale Vlorë <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/07/Vlora-Prioritetet-A3-Kontrata.pdf>

Linqe të Konsultuara

http://openprocurement.al/sq/tender/view/id/38551?fbclid=IwAR3KW58NUuDeS33ADmYEpYIEpDwXwiq6te6KGlwfnnilzrCtkcnDrpk_Yw.

<http://openprocurement.al/sq/tender/view/id/37256?fbclid=IwAR2kfktdCOeCIXNzkaPeYqBLxGiciQRo5mNWN-8ZAYiKhTPbNmAkX3zcdq0>

http://openprocurement.al/sq/tender/view/id/34673?fbclid=IwAR0t4pVn8kmywbF0vmr27W_G7MsKqoN_Yxf4Tmyu4kSbqFOegos126ujAEI

<https://apollon.tv/vlore-banoret-kerkojne-rikonstrukcionin-e-rruges-se-amortizuar/>

http://openprocurement.al/sq/tender/view/id/36581?fbclid=IwAR2zK_Oo74IHKB4JiSKEBSMrVVvQ2YuCzxCJK5vhVCgrr4JRgeh0lzNlZDs

<https://portavendore.al/2020/09/17/vlora-pa-uje-mijera-banor-jetojne-si-ne-mesjete/>

<https://dosja.al/banoret-e-fshatit-panaja-te-vlores-ne-proteste-kemi-dy-jave-pa-pike-ujj-ne-cezma-moren-votat-ne-fushate-dhe-iken/>

<https://www.monitor.al/hapet-gara-per-rikonstrukcionin-e-rrjetit-te-ujit-te-pijshem-ne-novosele-projekti-me-vlere-734-mln-leke-perfundon-ne-2024/>

ANEKS

Tabela krahasuese e monitorimit të progresit të prioriteteve të Kontratës Sociale.

PRIORITETI	Periudha Gusht 2019- Gusht 2020	Periudha Shtator 2020- Shtator 2021	Realizimi
PRIORITET 1: Investime që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe blloqet e brendshme të banimit..	50%	70%	Progres i adresuar pjesërisht
<i>Për rajonet e qytetit Vlorë. I nevojshëm rikonstruksioni i rrugëve ose i blloqeve të brendshme të banimit: Zona tek Fusha e Drurit, rruga tek Tregu i Madh, rruga pas KSHA-së, lagjia pas kopshtit Nr 10, rruga nga fabrika e tullave, rruga nga Porti drejt plazhit të vjeter, rruga “Jani Kosta”, rruga dhe e gjithë lagjia pas Stadiumit, rruga tek fusha e aviacionit. Vendosje e sinjalistikës horizontale dhe/ose vertikale në zonat ku aktualisht mungon.</i>	50%	70%	Prioritet i adresuar pjesërisht
<i>Novoselë. Ka nevojë për ndërhyrje urgjente në rrugët kryesore në fshatrat: Trevllazër, Cerkovinë, Skroftinë, si dhe rruga e varrezave Cerkovinë</i>	100%	100 %	Prioritet i realizuar plotësisht
<i>Orikum. I nevojshëm rikonstruksioni i rrugës tek Kisha e Marmiroit, rrugës buzë detit, rrëza e kanalit Dukat, rrugët e brendshme në Tragjas. Zgjerim i rrugëve të Rradhimës dhe të Thilpetit.</i>	10%	30%	Prioritet i pa realizuar
<i>Qendër Vlorë. Kërkohet ndërhyrje urgjente në rruget lidhëse të Bestrovës, Kërkovës, Hoshtimës, Sherishtës, Babicë e Vogël dhe Xhyherinës.</i>	40%	70%	Prioritet i realizuar pjesërisht
<i>Shushicë. Kërkohet rikonstruksion i rrugës Shushicë-Beshisht, rrugës së varrezave në fshatin Drithas dhe rrugës kryesore në Shushicë.</i>	50%	80%	Prioritet i realizuar
PRIORITET 2: Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë për	36%	56%	Prioritet i adresuar pjesërisht
<i>Rajonet e qytetit të Vlorës. Furnizimi me ujë në zonat ku aktualisht ka ujë vetëm një herë në 24 orë. Përmirësim i cilësisë së ujit të pijshëm</i>	50%	70%	Prioritet i adresuar pjesërisht

Novoselë. Ndërhyrje në rrjetin e amortizuar që krijon probleme me furnizimin vecanërisht gjatë verës.	20%	60%	Prioritet i pa realizuar
Orikum. Me prioritet ndërhyrjet në Dukat të Ri dhe Dukat fshat.	80%	90%	Prioritet i realizuar
Qendër. Furnizim me ujë për fshatrat Bestrovë, Babicë e Vogël, Hoshtimë, Kërkovë dhe Panaja.	10%	40%	Prioritet i pa realizuar
Shushicë. Furnizim me ujë për fshatrat Llakatund, Beshisht dhe Bunavi, përmirësim i cilësisë së ujit në Drithas dhe Grabian.	20%	20%	Prioritet i pa realizuar
PRIORITET 3: Përmirësim të cilësisë së kanalizimeve në secilën prej njëjësive vijuese:	60%	65%	Prioritet i adresuar pjesërisht
Rajonet e qytetit Vlorë. Kryerje e investimeve në rrjetin e kanalizimeve në zonat periferike dhe vënia në funksion e impiantit të përpunimit të ujrave të zeza në zonën e bregdetit.	80%	90%	Prioritet i realizuar
Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë dhe Shushicë. Ndërhyrje në sistemin e kanalizimeve, me prioritet në Njësinë Administrative Qendër dhe Shushicë dhe në zonat ku kanalizimet funksionojnë me gropa septike, si dhe specifikisht në fshatrat Mifol dhe Akërne.	40%	40%	Prioritet i adresuar pjesërisht
PRIORITET 4: Zgjidhje e problemit të transportit për fëmijët e shkollës në Dukat dhe të shkollës së Sherishtës.	100%	100 %	Prioritet i realizuar
PRIORITET 5: Shtim i shërbimit të transportit urban dhe në lagjet periferike të qytetit. Orare fikse, linja më të shpeshta transporti dhe rritje e orarit të shërbimit përtej orës 18.00	50%	50 %	Prioritet i adresuar pjesërisht
PRIORITET 6: Të vihet në funksion impianti i venddepozitimit të mbeturinave në Sherishtë	50%	80%	Prioritet i adresuar pjesërisht
PRIORITET 7: Përmirësim i cilësisë së pastrimit sipas nevojave të secilës njësi:	20%	42%	Prioritet i adresuar pjesërisht
Rajonet e qytetit Vlorë. Shërbim cilësor dhe shtimi i koshave në disa zona të qytetit, sidomos gjatë sezonit turistik. Të shtohen masat e kontrollit të Bashkisë në zonat ku banorët bëjnë djegie të mbetjeve kryesisht plastikave, veçanërisht në ish-fushën e druve dhe ish-fushën e aviacionit.	80%	80%	Prioritet i adresuar pjesërisht
Novoselë. Vendosja e koshave për mbledhjen e mbeturinave në çdo fshat. Nevojitet të shtohen 140 kosha të tjerë.	0%	30%	Prioritet i pa realizuar
Orikum. Vendosje e koshave në lagjet brenda fshatrave dhe dizinfektimi i koshave egzistues. Eleminimi i plotë i diegies së plehrave	10%	20%	Prioritet i pa realizuar
Qendër Vlorë. Bashkia të kontraktojë firmë pastrimi ose nëpërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike te vendosë kosha për mbledhjen e mbeturinave në të gjitha fshatrat. Mbledhja sistematike e	10%	40%	Prioritet i pa realizuar

<i>mbeturinave nga makinat e pastrimit në të gjitha fshatrat e kësaj njësie.</i>			
Shushicë. Urgjente shtimin i koshave të mbetjeve në të gjithë njësinë. Prioritet pastrimi në fshatrat Risili, Çepirat, Mekat, Bunavi, Beshisht dhe Drithas.	10%	40%	Prioritet i pa realizuar
PRIORITET 8: Zhvillim i programeve për mbështetjen e fermerëve, si dhe përfundim i procesit të menaxhimit të tokave.	50%	70%	Prioritet i adresuar pjesërisht
PRIORITET 9: Zhvillimi i një mekanizmi efektiv nga Bashkia për mbledhjen e taksave ku të përfshihen edhe fushata informimi e komunikimi me komunitetin mbi mbledhjen dhe rishpërndarjen e tyre.	10%	40%	Prioritet i pa realizuar
PRIORITET 10: Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për të rinjtë dhe gratë.	10%	60%	Prioritet i pa realizuar
PRIORITET 11: Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv (Buxheti me Pjesmarrje) për të marrë këndvështrimin e komunitetit mbi vendimarrjet më të rëndësishme, duke: <i>-mos u limituar vetëm tek konsultimi i buxhetit por dhe mbledhje të nevojave të qytetarëve;</i> <i>- përdorur edhe forma të tjera konsultimi përveç takimeve me komunitetin, si dhe duke rritur numrin e takimeve konsultuese;</i> <i>-mundësuar përfshirjen e gjerë të komunitetit në këto procese;</i> <i>-raportuar sistematikisht në komunitetet se sa prej mendimeve të komunitetit janë reflektuar në vendimarrjet e saj.</i>	80%	90%	Prioritet i realizuar
PRIORITET NR.12: Të krijohet Këshilli Rinor Vendor për të rritur pjesmarrjen e të rinjve në vendimarrjen lokale.	50%	60%	Prioritet i adresuar pjesërisht
TOTALI	47,17%	65,25%	Prioritete të adresuara pjesërisht